



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:158345  
Datë: 07.02.2025  
Numri i dokumentit: 06817635

PML.nr.65/2025

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Valdete Daka, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit O. Z., për shkak të veprës penale grabitja nga neni 317 par.3 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.71/2024 të datës 30.12.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.42/2025 të datës 17.01.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.02.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit O. Z., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.71/2024 datë 30.12.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.42/2025 datë 17.01.2025.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.71/2024 datë 30.12.2024, të pandehurit F. K., A. Ll., T. P., O. Z. dhe M. M., për shkak të veprës penale grabitja nga nenin 317 par. 3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, i ka shpallur fajtorë dhe i ka gjykuar me dënim me: të pandehurin F. K. me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) vite dhe me dënim me gjobë në shumë prej dymijë euro (2000€), të pandehurin T. P. me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) vite dhe me dënim me gjobë në shumë prej dymijë euro (2000€), të pandehurin A. Ll. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vite e gjashtë (6) muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej njëmijë euro (1000€), të pandehurin M. M. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vite e gjashtë (6) muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej njëmijë euro (1000€), dhe të pandehurin O. Z. me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) viteve dhe me dënim me gjobë në shumë prej njëmijë euro (1000€), të pandehurve në dënimet e shqiptuara u llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.71/2024 të datës 30/12/2024, të pandehurve M. M., O. Z., T. P., A. Ll. dhe F. K., për shkak të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtorë, me aktgjykimin Pkr.nr.71/2024 të datës 30.12.2024, ua ka vazhduar masën e paraburgimit nga data 30.12.2024 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me aktgjykim. Masa e paraburgimit iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 366 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 184 par. 1 nën-par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të rënda, me aktvendimin PN.1.nr.42/2025 e datës 17.01.2025, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve, dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit O. Z., av. Sabit Rama, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale lidhur me vazhdimin e masës së paraburgimit, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të lirohet për t'u mbrojtur në liri.

Kryeprokurori i Shteti, me shkresën KMLP.III.nr.28/2025 të datës 05.02.2025, ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit thekson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e paraburgimit, ngase nuk ka dyshim të bazuar si i pandehuri ka kryer veprën penale si dhe se të pandehurit i dihet identiteti, i njëjti është shtetas i Kosovës, posa ka mbushur moshën madhore, vetë është paraqitur në polici, ka qenë bashkëpunues, e ka pranuar

fajësinë, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, ka qëndruar nën masën e paraburgimit nga data 04.06.2024, dhe se nuk ka as rrezik të ikjes e as rrezik të përsëritjes.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara, ngase në rastin konkret ka kushte ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 366 par. 1 pika 1.1 lidhur me par. 2 lidhur me nenin 184 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPP, ngase duke pasur parasysh faktin se i pandehuri nga koha e kryerjes së veprës penale ka qenë i paarritshëm për organet e drejtësisë deri me datën 04.06.2024, dhe se duke pasur parasysh mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë, këmbëngulësinë, duke përdorur forcën, e shtojnë rrezikun se po të gjendej i pandehuri në liri, do të mund të vij deri ikja apo arratisja dhe deri te përsëritja ose kryerja e ndonjë vepre tjetër penale - të njëjtë apo të ngjashme.

Pretendimet e mbrojtësit për ndërprerjen e paraburgimit nuk janë të bazuara dhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, vazhdimi i paraburgimit është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Pretendimet e mbrojtësit se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe ka shprehur gatishmëri për bashkëpunim me organet e drejtësisë, janë rrethana të cilat nuk kanë peshë relevante në lidhje me vazhdimin respektivisht ndërprerjen e paraburgimit.

Nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave ligjore të procedurës penale lidhur me vazhdimin e paraburgimit, nga sa u tha më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Pml.nr.65/2025, më datë 06.02.2025

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,  
Rasim Rasimi